



RAPORT VJETOR
ANNUAL REPORT

2016

SIGMA **INTERALBANIAN** 
VIENNA INSURANCE GROUP

Momente të rëndësishme të kompanisë Sigma Interalbanian VIG Sh.A

Shkurt 1999	Themelohet kompania e pare private e Sigurimeve, SIGMA
Tetor 2002	Sigma fillon zgjerimin e saj në rajon, me hapjen e degës së saj në Maqedoni.
Shtator 2004	Sigma vazhdon shtrirjen e aktivitetit dhe fillon të operojë në tregun e Kosovës, nëpërmjet degës së saj, Sigma Kosovë.
Shtator 2007	Grupi më i madh i sigurimeve në Evropën Lindore dhe Qendrore, vendos të hyjë në tregun shqiptar nëpërmjet blerjes së mazhoritetit të aksioneve të Sigma sh.a.
Tetor 2014	Bëhet bashkimi i kompanive Sigma dhe Interalbanian, të dyja pjesë e Vienna Insurance Group, të cilat tashmë operojnë nën emrin Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group.
Maj 2016	Tërhiqet nga detyra lideri historik i kesaj kompanie, Z. Qemal Disha, dhe pasohet nga Drejtori i Përgjithshëm, z. Klaidi Çitozi.



Misioni

Të identifikojmë burimet ende të pashfrytëzuara në lëmin e sigurimeve dhe të bëhemi zgjedhja e parë e klientëve, veçanërisht në sigurimet vullnetare, duke punuar me përgjegjshmëri, përkushtim dhe integritet.

Vizioni

Të jemi zgjedhja e padiskutueshme e klientëve për sigurimet e jo jetës në Shqipëri dhe Kosovë dhe të ofrojmë shërbim cilësor në trajtimin e dëmeve.




Mjedisi ekonomik është në ndryshim të vazhdueshëm. Ne u paraprijmë nevojave të klientëve duke krijuar produkte për të cilat ata mund të kenë nevojë si dhe investojmë në teknologji që këto produkte të jenë lehtësisht të arritshme nga ata.

Vlerat Tona

Ambicia jonë është që të jemi Sigurues të standarteve të larta, e matur kjo nëpërmjet opinionit dhe sadsfaksionit të klientëve tanë, qetësisë së punonjësve, përfitueshmërisë së investitorëve dhe komunitetit në të cilin punojmë dhe jetojmë. Modeli ynë i biznesit krijon vlerë për të gjitha grupet e interesit.

Ne ndihmojmë **klientët** që të kuptojnë rreziqet me të cilat mund të përballen çdo ditë si dhe të gjejnë zgjidhje të arsyeshme që ata të ndihen të mbrojtur dhe të sigurt.



Ne investojmë tek **punonjësit** tanë që ata të përmirësohen profesionalisht, në mënyrë që ata të japin më të mirën e tyre në shërbim të kompanisë.

Ne rrisim çdo ditë vlerën e kompanisë, duke iu përmbajtur standarteve më të larta të etikës dhe duke zbatuar strategjinë tonë, duke e bërë kështu kompaninë më fitimprurëse për **aksionerët** tanë.

Komuniteti në të cilin punojmë dhe jetojmë, përfiton jo vetëm nëpërmjet biznesit tonë të sigurimeve, por njëkohësisht rrisim dhe mirëqënien sociale, duke ofruar vende pune dhe duke ndikuar në rritjen ekonomike. Ne gjithashtu përfshijmë përgjegjësinë sociale në çdo aktivitet tonin.



Mesazh nga Drejtori i Përgjithshëm, Z. Klaidi Çitozi

Të nderuar klientë, bashkëpunëtorë, aksionerë dhe miq!

Viti 2016, ishte një vit sfidash dhe ndryshimesh të mëdha për Sigma Interlbanian VIG. Pavarësisht situatës financiare në Shqipëri, tregut jo të zhvilluar si dhe fokusimit në sigurimet e detyrueshme, kompania jonë arriti të ketë rezultate të kënaqshme si dhe arritje të mira në treg.

Gjatë këtij viti, m'u ngarkua përgjegjësia e drejtimit të SIVIG, pas tërheqjes së liderit historik të kompanisë, por dhe themeluesit të sigurimeve në Shqipëri, Z. Qemal Disha.

Megjithëse i ri në drejtim, unë kam qënë pjesë e kompanisë prej 13 vitesh, duke njohur kështu në detaje çdo problematikë apo avantazh konkures të saj. Ndaj sfida ime personale, ishte përmirësimi i pozicionit të kompanisë në treg, duke u përpjekur të frenoj efektet negative të problemeve të trashëguara. Mbjajtja e klientëve ekzistues, gjetja e klientëve të rinj, si dhe administrimi efikas i shpenzimeve kanë qënë objektivat tona që prej fillimit të vitit.

Sigurimet kanë në themel besimin e klientëve, ndaj dhe ne përpiqemi fort që të vazhdojmë të kemi besimin e klientëve tanë, si dhe të garantojmë përmbushjen e detyrimeve tona edhe ndaj prurjeve të reja. Ne jemi kompania që paguan më shumë dëme në tregun e sigurimeve, më shumë se ¼ e totalit të dëmeve të tregut, sepse ne vendosim klientin në qëndër të punës tonë. Kjo reflektohet edhe ne normën e lartë të rinovimeve që ka kompania jonë.

Klientët vazhdojnë të besojnë tek ne, vazhdojnë të na zgjedhin. Dhe ne, në të njëjtën mënyrë, do të vlerësojmë të gjitha rastet në mënyrë korrekte dhe të paguajmë në kohën e duhur dëmet e shëndetit, pasurisë dhe të automjeteve.



Besimi juaj, detyrimi ynë!

Nëpërmjet aplikimit të parimeve të marrjes në sigurim, administrimit të rreziqeve me kontrata risigurimi të klasit parë, ne mundemi të marrim përsipër me garanci të plotë çdo lloj rreziku. Në çdo kontratë sigurimi jemi të mbuluar përveç se me kapacitetet tona, edhe me mbështetjen e VIG Re, e cila është e vlerësuar nga Standarts and Poors me A+.

Mbështetja e padiskutueshme e aksionerit tonë kryesor, Vienna Insurance Group, na vë njëherësh edhe përpara përgjegjësisë që të synojmë t'i përmbahemi standarteve më të larta në ofrimin e shërbimeve.

VIG, rrënjët e të cilit datojnë më shumë se 190 vite më parë në Austri, operon në 25 vende të Europës Lindore dhe Qendrore. Ka një prej vlerësimeve më të mira nga Standards and Poors, A+ dhe një perspektivë e qendrueshme, ndër kompanië e përfshira në indeksin ATX të Vienna Stock Exchange.

Dega jonë në Kosovë, vazhdon të jetë një histori suksesi, që prej shumë vitesh tashmë, dhe është një nga kompanitë lidere ne treg bazuar ne volumin e primeve te realizuara per te gjitha linjat e bizneseve.

Mbyllja e vitit 2016, i dha një mundësi reale një fillimi të suksesshëm të 2017, për rritje të treguesve financiarë të kompanisë, veçanërisht në sigurimet vullnetare. Këto janë një motiv i mirë që ne të përpiqemi më tepër për të arritur objektivat tona ambicioze. Ne presim që 2017 të sjellë një pozicion më të konsoliduar në treg sepse kemi kapacitetet e duhura teknike dhe financiare për të mbajtur klientët ekzistues dhe për të tërhequr klientë të rinj.

Unë falenderoj nga zemra të gjithë ata që kanë zgjedhur Sigma InterAlbanian VIG, pasi siç është dhe slogani ynë ndër vite, besimi juaj është detyrimi ynë.

Ne i garantojmë ata që mbajmë premtimet dhe përmbushim detyrimet tona!

Tregues të tregut të Shqiptar të Sigurimeve

Në fund të vitit 2016, tregu shqiptar i sigurimeve arriti shifrën e primeve të shkruara ALL 15,466 million (rreth 114 milion Euro), ose një rritje prej 9.64% sipas shifrave të publikuara nga AMF. Vlera totale e dëmeve të paguara ishte 4,276 milion lekë, duke shënuar një rritje prej 17.54%. nga këto dëme më shumë se gjysma (rreth 52%) janë paguar për Sigurimin e Detyrueshëm TPL.

Përgjithësisht, gjatë 2016, numri i kontratave të lëshuara ka shënuar një rritje të lehtë prej 2.66%, dhe një total prej 1,126,233. Tregu edhe këtë vit është dominuar nga sigurimet e jo jetës, të cilat zënë edhe 93.13% të totalit të tregut.

Gjithashtu, në strukturën e primeve të tregut vazhdojnë të dominojnë sigurimet e detyrueshme, nga të cilat vijnë 62% e primeve dhe pjesa tjetër, 38% vjen nga sigurimet vullnetare. Vlen të përmendet që numri i kontratave vullnetare ka rënë me 3.1% krahasuar kjo me vitin 2015.

Sipas linjave të biznesit, të ardhurat nga primet dominohen nga sigurimet e detyrueshme motorike. Përgjithësisht vlera e primit të shkruar bruto ishte 9.509 milion, duke treguar kështu një rritje prej 12.19% krahasuar me 2015. Vihet re gjithashtu se të treja nënklasat kanë pasur një rritje dyshifrore jo vetëm të volumit të primeve por edhe të numrit të kontratave, si më poshtë:




Policat e zjarrit dhe rreziqeve shtesë, megjithëse kanë pësuar një rënie në prime prej 11% dhe në numër kontratash me gati 15%, ende mbetet një ndër portofolet kryesore të Sigurimeve vullnetare të cilat sjellin rreth 9% të totalit të primeve të tregut.

Rreth Sigma Interalkanian VIG

Sigma u themelua në 1999. Aktiviteti i saj kryesor është ofrimi i sigurimit për mjetet motorike, pronën, shëndetin dhe sigurime të tjera jo-jetë.

Sigma Interalkanian VIG i foron shërbimet e saj në Shqipëri dhe Kosovë, nëpërmjet 350 punonjësve të saj.

Pjesa e tregut të kompanisë




25% të primeve totale vijnë nga sigurimet vullnetare, duke përfshirë këtu sigurimin e pronës, shëndetit, kaskos dhe përgjegjësisë. Në sigurimet e pronës renditet kompania e tretë në treg me afërsisht 12% të tregut.


Të ardhurat nga primet për vitin 2016 ishin mbi 25 milion Euro. Aktualisht është kompania e tretë në treg me rreth 15% të tregut. Duke qënë se klienti është në qendër të punës tonë, ne vazhdojmë të jemi kompania që paguan më shumë dëme në treg, rreth 34% më shumë dëme se viti i kaluar, dhe konkretisht paguajmë 25.7% të dëmeve të tregut.

Sigma Interalkanian VIG, renditet kompania e dytë në sigurimet motorike, duke shënuar një rritje të lehtë në krahasim me vitin e kaluar dhe zotëron 16.26% të tregut të motorikeve.


Dëmet e paguara nga kompania në krahasim me tregun



Primet e shkruara Bruto të kompanisë ndër vite



Dëmet e paguara nga kompania ndër vite





138.1%

Marzhi i Aftësisë Pague



141.3%

Mbulimi me rezerva



17.7
Milion Euro

Provigjionet Teknike



33
Milion Euro

Aktive



7.3
Milion Euro

Kapitali



Shtirja e SIVIG

Duke qënë pjesë e grupit të sigurimeve lider, në Evropën qendrore dhe lindore, Vienna Insurance Group ne mund të garantojmë që do të jemi partnerët tuaj, jo vetëm në Shqipëri. Profesionalizmi, korrektesia dhe besimi reciprok janë mjeti që na çojnë drejt suksesit dhe që gjenerojnë klientë të kënaqur.


Kush janë klientët tanë?

Klientët e Sigma InterAlbanian VIG ju shërben më shumë se 111.000 klientëve, të cilët janë janë individët, bizneset e vogla dhe të mëdha si dhe korporatat globale, të cilët gjejnë tek ne jo vetëm një shërbim të shkëlqyer por edhe produkte sigurimi standarte apo dhe sipas nevojave specifike të tyre.

Kush janë partnerët tanë?

Në punën tonë ne mbështetemi nga Kompani Risigurimi me vlerësime maksimale nga Standarts and Poors, të cilat jo vetëm na mundësojnë të marrim përsipër rreziqe të mëdha por herë pas here na japin edhe nga ekspertiza dhe eksperiencia e tyre.

Përveç shitjeve direkte që bën kompania, një pjesë e rëndësishme e të ardhurave tona, vjen nëpërmjet shitjeve që bëjnë agjentët, bankat, brokerat, konçensionarët, etj.



mbi 111.000 klientë në 2016

Kush janë aksionerët tanë?

Kapitali aksioner i Shoqërisë në 31 dhjetor 2016 është 695,236 mijë Lek i ndarë në 39,627 aksione me vlere nominale 12,572.57 ALL.

Vienna Insurance Group	89.05 %
Znj. Shpresa Prodani	4.49 %
Z. Qemal Disha	3.73%
Z. Rasim Disha	0.75%
Znj. Shefikat Ngjela	1.23%
Z. Idajet Kuka	0.75%

Bordi Mbikqyres

Z. Peter Hoefinger Kryetar
Znj. Sonja Raus Anëtar
Z. Christoph Rath Zv.Kryetar
Z Jonard Prodani Anëtar
Znj.Shefikat Ngjela Anëtar

Bordi Drejtues

Z. Klaidi Citozi Drejtor i Përgjithshëm
Z. Enid Minarolli Zv. Drejtor i Pergjithshem
Z. Ervin Rali Anëtar

Rreth VIG

Vienna Insurance Group (VIG) është një kompani e pozicionuar mirë në të gjitha linjat e biznesit dhe si e tillë ofron një portofol produktesh dhe shërbimesh të plotë të orientuar drejt klientit, në më shumë se 50 kompani të Grupit dhe me rreth 24.000 punonjës në 25 vende. Grupi gjeneroi rreth 9 miliardë Euro në prime në vitin 2016, duke forcuar më tej pozicionin lider në treg në Austri dhe në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, ku VIG ka mbi 25 vite që operon.

Shtrirja e suksesshme e VIG ne rajonin e Europës Qendrore dhe Lindore

Rrënjët e VIG datojnë që prej më shumë se 190 vitesh në Austri, kohë në të cilën Kompania u zhvillua që në fillim si një sigurues lokal në 1824 dhe arriti të bëhet një grup ndërkombëtar sigurimesh. Në 1990, disa vizionarë në Wiener Städtische panë mundësitë e shumta të ofruara në rajonin e Europës Qendrore dhe Lindore dhe ndërmorën riskun e hyrjes në treg në ish-Çekosllovakë. Zgjerimi vazhdoi në vitet në vijim. Nga Estonia në Shqipëri dhe nga Gjermania në Gjeorgji, ngadalë u mbulua plotësisht i tërë rajoni. Shtrirja në Republikën e Moldavisë në vitin 2014 mbuloi hapësirën e mbetur të shtrirjes në të gjithë rajonin e Europës Qendrore dhe Lindore.



Përdor forcën e kombinuar për t'u bërë numri 1

VIG ka arritur të jetë një ndër kompanitë më të suksesshme në tregun e sigurimeve në shumë vende në vitet e kaluara. Duke përdorur një strategji të fokusuar tek rritja dhe tek perspektiva afatgjatë, ka krijuar një bazë të qëndrueshme e cila bëri të mundur që Grupi të arrijë përqindje të pjesmarrjes në treg në vlera dyshifrore.

Shifrat për rajonin tregojnë se vendimi për t'u shtrirë në Europën Lindore dhe Qendrore ishte ai i duhuri. Në 2016, rreth gjysma e volumit total të primeve të VIG, prej rreth 9 bilionë Euro, u gjenerua në tregjet e Europës Lindore dhe Qendrore. Grupi vazhdon të besojë në potencialin që ofrojnë rritjet e vazhdueshme të ekonomisë në rajon, e cila sjell dhe një rritje të kërkesës për produkte sigurimi.

Rëndësia e rajonit u konfirmua nga një vendim tjetër i Grupit në vitin 2008, për të themeluar një zyrë të regjistruar të kompanisë së risigurimit VIG Re në Republikën Çeke.

Fokusimi i përbashkët në aktivitetin thelbësor

Vendimet e mësipërme hapin rrugën e ndjekur nga VIG dhe forcojnë fokusin në sigurime si aktivitetin thelbësor. Ndiqet një strategji sigurimi progresive dhe tepër e ndërgjegjshme ndaj riskut. Serioziteti, besueshmeria dhe fuqia karakterizojnë marrëdhëniet me partnerët në biznes, punonjësit dhe aksionarët.

Kjo përjasje themelore reflektohet gjithashtu në strategjinë e saj për rritje të qëndrueshme dhe stabilitet kreditor. Agjencia ndërkombëtare e vlerësimit Standard & Poor's ka konfirmuar zhvillimin e VIG me vlerësimin A+ me parashikim të qëndrueshëm për shumë vite. VIG vijon të ketë vlerësimin më të mirë ndër të gjitha kompanitë e ATX, indeksi lider në Vienna Stock Exchange.


Përkrah klientëve tanë

Besimi i klientëve dhe afërsia me ta janë faktorë madhorë në suksesin e VIG. Punonjësit lokalë njohin shumë mirë nevojat e klientëve tanë, prandaj VIG vendos besimin e saj tek këta punonjës dhe sipërmarrësit lokalë.

Në mënyrë që të krijohet stabilitet dhe besim, Grupi përdor një strategji me shumë brande, e cila ruan brande të suksesshme dhe i bashkon ato nën cadrën e Vienna Insurance Group. Kjo gjithashtu lejon përdorimin e një shumëllojshmërie të gjerë të kanaleve shpërndarëse. Orientimi i strategjisë së kompanisë përmbledhet nga një politikë e matur e investimit dhe risigurimit.

Erste Group dhe VIG: bashkë të fortë

Erste Group është e vendosur fuqishëm në Austri dhe është një nga aktorët më të suksesshëm në rajonin e Europës Qendrore dhe Lindore. Partneriteti strategjik ndërmjet Erste Group dhe VIG filloi në vitin 2008 dhe është rritur e forcuar gjatë tetë viteve të fundit. Kompanitë e Grupit VIG i ofrojnë Erste Group produkte, dhe nga ana tjetër, degët e Erste Group shesin produkte sigurimi.



Politika e dividendit të qëndrueshëm te Grupit

VIG është e listuar ne Vienna Stock Exchange që nga viti 1994. Sot ajo është një nga kompanitë lider në segmentin e tregut primar, dhe i ofron aksionarëve një politikë tërheqëse të dividendit me një raport të pagesës së dividendit prej të paktën 30% të fitimeve të Grupit (pas taksave dhe pjesëmarrjeve jo-kontrolluese).

Rëndësia e zonës ekonomike të Europës Qendrore dhe Lindore u përforcua edhe njëherë me listimin e dytë të Kompanisë ne Prague Stock Exchange në shkurt të vitit 2008. Aksionet e VIG vlerësohen si një nga kompanitë lider atje.

Struktura aksionare ka mbetur e qëndrueshme që nga rritja e kapitalit në vitin 2005. Rreth 70% e aksioneve zotërohen nga aksionari kryesor, Wiener Städtische Versicherungsverein. Pjesa e mbetur prej 30% e aksioneve është në shitje të lirë.


Në kërkim të më të mirës së bashku

Të gjitha kompanitë e Grupit VIG luftojnë për të tërhequr punonjësit më të talentuar dhe inteligjentë. Si rezultat, menaxhimi i burimeve njerëzore i kompanisë ka si prioritet kryesor identifikimin dhe zhvillimin e aftësive individuale. Promovimi i diversitetit është gjithashtu tepër i rëndësishëm, sic është edhe krijimi i një strukture që ofron mundësitë e duhura të zhvillimit të punonjësve. Kjo ndodh pasi VIG e ka të qartë që suksesi ndërtohet mbi dedikimin e 23,000 punonjësve të saj.

THE LEADING INSURANCE SPECIALIST IN AUSTRIA AND CEE.



<p>AUSTRIA</p> <p>WIENER STÄDTISCHE VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>onau VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>S-VERSICHERUNG VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>SLOVAKIA</p> <p>Kooperativa VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>KOMUNÁLNA POISTOVŇA VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>POIŠTOVNĀ SLOVENSKEJ SPORITELNE VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>BULGARIA</p> <p>BULSTRAD VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>Life BULSTRAD VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>ESTONIA</p> <p>COMPENSA VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>TURKEY</p> <p>RAYSIGORTA VIENNA INSURANCE GROUP</p>
<p>ITALY BRANCH</p> <p>WIENER STÄDTISCHE VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>onau VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>POLAND</p> <p>COMPENSA VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>InterRisk VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>POLISA-ŻYCIE VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>CROATIA</p> <p>WIENER OSIGURANJE VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>ERSTE OSIGURANJE VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>LATVIA</p> <p>COMPENSA VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>Baltikums VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>ETA</p>	<p>ALBANIA</p> <p>SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP</p>
<p>SLOVENIA BRANCH</p> <p>WIENER STÄDTISCHE VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>Vienna Life VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>HUNGARY</p> <p>UNION BIZTOSÍTÓ VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>ERSTE BIZTOSÍTÓ VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>viennalife VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>LITHUANIA</p> <p>COMPENSA VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>MACEDONIA</p> <p>ОСИГУРУВАЊЕ МАКЕДОНИЈА VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>WINNER VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>Life WINNER VIENNA INSURANCE GROUP</p>
<p>CZECH REPUBLIC</p> <p>Kooperativa VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>ČPP VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>POJIŠTOVNĀ ČESKÉ SPORITELNY VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>VIG Re</p>	<p>ROMANIA</p> <p>OMNIASIG VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>ASIROM VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>DE VIATA BCR ASIGURARI VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>SERBIA</p> <p>WIENER STÄDTISCHE VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>MOLDOVA</p> <p>DONARIS VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>MONTENEGRO</p> <p>Život WIENER STÄDTISCHE VIENNA INSURANCE GROUP</p>
		<p>UKRAINE</p> <p>КНЯЖА VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>Life КНЯЖА VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>ГЛОБУС VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>УКРАЇНСЬКА СТРАХОВА ТОВАРИСТВО VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>BELARUS</p> <p>КУПАЛА VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>BOSNIA HERZEGOVINA</p> <p>WIENER OSIGURANJE VIENNA INSURANCE GROUP</p>
			<p>GEORGIA</p> <p>GPIA VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>IRAQ VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>GERMANY</p> <p>InterRisk VIENNA INSURANCE GROUP</p>
				<p>LIECHTENSTEIN</p> <p>VIENNA-LIFE VIENNA INSURANCE GROUP</p>



Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group sh.a.

Pasqyrat Financiare më 31 dhjetor 2016
(me opinionin e audituesit të pavarur)

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

Per Aksionaret e SigmaInteralbanian Vienna Insurance Group sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te SigmaInteralbanian Vienna Insurance Group sh.a ("Shoqeria"), te cilat perfshijne pasqyren e pozicionit financiar me daten 31 dhjetor 2016, pasqyren e te ardhurave gjithperfshirese, pasqyren e ndryshimeve ne kapital dhe pasqyren e fluksit te mjeteve monetare per vitin qe mbyllet me kete date, si edhe shenimet per pasqyrat financiare, perfshire nje permbledhje te politikave kontabel me te rendesishme.

Sipas opinionit tone, pasqyrat financiare bashkelidhur paraqesin drejt. ne te gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar te Shoqerise me 31 dhjetor 2016, dhe rezultatin e saj financiar dhe fluksin e mjeteve monetare per vitin e mbyllur ne ate date, ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar ("SNRF").

Çeshtje te tjera

Pasqyrat financiare te Shoqerise per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2015 jane audituar nga nje tjetër auditues i cili ka leshuar nje opinion te pamodifikuar me 19 prill 2016.

Baza per opinionin

Ne e kryem auditimin tone ne perputhje me Standardet Nderkombetare te Auditimit ("SNA-te"). Pergjegjesite tona sipas ketyre standardeve jane pershkruar ne menyre me te detajuar ne seksionin e raportit ku jepen Pergjegjesite e Audituesit per Auditimin e Pasqyrave Financiare . Ne jemi te pavarur nga Shoqeria ne perputhje me Kodin e Etikes per Profesionistet Kontabel te Bordit te Standardeve Nderkombetare te Etikes per Profesionistet Kontabel ("Kodi i BSNEPK ") se bashku me kerkesat etike qe jane te zbatueshme per auditimin e pasqyrave financiare ne Shqiperi, dhe kemi permbushur pergjegjesite e tjera etike ne perputhje me keto kerkesa dhe me Kodin BSNEPK . Ne besojme se evidenca e auditimit qe kemi siguruar eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te dhene nje baze per opinionin tone .

Pergjegjesite e Drejtimit dhe Keshillit Mbikeqyres per Pasqyrat Financiare

Drejtimi eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te pasqyrave financiare ne perputhje me SNRF-te, dhe per ato kontrole te brendshme, qe Drejtimi i gjykon te nevojshme per te bere te mundur pergatitjen e pasqyrave financiare qe nuk permbajne anomali materiale, qofte per shkak te mashtrimit apo gabimit.

Ne pergatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi eshte pergjegjes per te vleresuar aftesine e Shoqeria per te vazhduar ne vijimesi, duke dhene informacion, nese eshte e zbatueshme, per eshtjet qe kane te bejne me vijimesine dhe duke perdorur parimin kontabel te vijimesise perve se ne rastin kur drejtimi synon ta likujdoje Shoqerine ose te nderprese aktivitetet. ose nese nuk ka alternative tjeter reale perve sa me siper.

Keshilli Mbikeqyres eshte pergjegjes per mbikeqyrjen e procesit te raportimit financiar te Shoqerise.

Pergjegjesite e audituesit per auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona jane qe te arrijme nje siguri te arsyeshme lidhur me faktin nese pasqyrat financiare ne teresi nuk kane anomali materiale, per shkak te mashtrimit apo gabimit, dhe te leshojme nje raport auditimi qe perfshin opinionin tone. Siguria e arsyeshme eshte nje siguri e nivelit te larte, por nuk eshte nje garanci qe nje auditim i kryer sipas SNA-ve do te identifikojte gjithmone nje anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalite mund te vijne si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nese, individualisht ose te marra se bashku, priten qe ne menyre te arsyeshme, te influencojne vendimet ekonomike te perdoruesve, te marra bazuar ne keto pasqyra financiare.

Si pjese e auditimit ne perputhje me SNA-te, ne ushtrojme gjykimin profesional dhe ruajme skepticizmin profesional gjate gjithe auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojme dhe vleresojme rreziqet e anomalise materiale, qofte per shkak te mashtrimit ose gabimit, hartojme dhe kryejme procedurat e auditimit ne pergjigje te ketyre rreziqeve, dhe marrim evidence auditimi qe eshte e mjaftueshme dhe e pershtatshme per te siguruar nje baze per opinionin tone. Rreziku i moszbulimit te nje anomalie materiale si rezultat i mashtrimit eshte me i larte se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund te perfshije marreveshje te fshehta, falsifikime, perjashtime te qellimshme, informacione te deformatuara, anashkalime te kontrolleve te brendshme.
- Sigurojme nje njohje te kontrollit te brendshem qe ka te beje me auditimin, me qellim qe te percaktojme procedurat e auditimit qe jane te pershtatshme sipas rrethanave, por jo per qellime te shprehjes se nje opinion mbi efikasitetin e kontrollit te brendshem te Shoqerise.
- Vleresojme pershtatshmerine e politikave kontabel te perdurura dhe arsyeshmerine e çmuarjeve kontabel dhe te shpjegimeve perkatese te bera nga drejtimi.
- Nxjerrim nje konkluzion ne lidhje me pershtatshmerine e perdorimit te bazes kontabel te vijimesise, dhe bazuar ne evidencen e auditimit te marre, nese ka nje pasiguri materiale ne lidhje me ngjarjet ose kushtet, te cilat mund te hedhin dyshime te medha per aftesine e Shoqerise per te vijuar veprimtarine. Nese arrijme ne perfundimin qe ka nje pasiguri ne duhet te terheqim vemendjen ne raportin e audituesit ne lidhje me shpjegimet e dhena ne pasqyrat financiare, ose nese keto shpjegime jane te papershtatshme, duhet te modifikojme opinionin tone. Konkluzionet tona bazohen ne evidencen e auditimit te marre deri ne daten e raportit tone. Megjithate, ngjarje ose kushte te ardhshme mund te bejne qe Shoqeria te nderprese veprimtarine.
- Vleresojme paraqitjen e pergjithshme, strukturen dhe permbajtjen e pasqyrave financiare, perfshire informacionet shpjeguese te dhena, dhe nese pasqyrat financiare paraqesin transakcionet dhe ngjarjet ne to ne nje menyre qe arrijne paraqitjen e drejte.

Ne komunikojme me Drejtimin dhe Keshillin Mbiqeqyres te Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group sh.a, pervec te tjerave, lidhur me qellimin dhe kohen e auditimit dhe gjetjet e rendesishme te auditimit, perfshire ndonje mangesi te rendesishme ne kontrollin e brendshem qe ne mund te identifikojme gjate auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega Shqipëri

Ernst & Young Certified Auditors
4 maj 2017
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjel
Ekspert Kontabël i Regjistruar

Mario Vangjel

SigmaInteralbanian Vienna Insurance Group sh.a.

Pasqyra e pozicionit financiar

(Të gjitha shifrat janë në mijë Lek, përveç rasteve kur theksohet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
AKTIVET			
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	10	222,696	188,555
Depozita me afat me banka	11	2,223,565	2,088,499
Bono Thesari	12	1,438,762	1,459,125
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera	13	235,693	255,177
Kostot e shtyra të marrjes në sigurim	14	324,672	290,743
Aktive të risigurimit	15	1,865,864	2,047,496
Parapagim tatim mbi fitimin	16	35,264	35,264
Aktive afatgjata material dhe jo-materiale	18	333,089	355,499
Ndërtesa të investuara	19	112,066	112,066
Aktive të tjera	20	189,176	201,308
Aksione në shoqëri të lidhura	21	10,063	10,063
Aktiv tatimor i shtyrë	17	-	13,936
TOTALI I AKTIVEVE		6,990,910	7,057,731
DETYRIMET			
Rezervat teknike për dëmet	22	2,402,051	2,555,745
Rezerva e primit të pafutuar	23	1,485,771	1,453,318
Taksa dhe detyrime të tjera	24	62,750	43,810
Llogari të pagueshme për sigurimin dhe të tjera	25	1,452,569	1,433,015
Detyrim tatimor i shtyrë	17	9,589	-
TOTALI I DETYRIMEVE		5,412,730	5,485,888
KAPITALI			
Kapitali themeltar	26	695,263	668,217
Rezerva të riskut të sigurimit	26	171,792	171,792
Rezerva e rivlerësimit	26	78,192	82,170
Rezerva e konvertimit		39,085	49,953
Rezerva e bashkimit	26	437,207	437,207
Fitimet e mbartura		156,641	162,504
TOTALI I KAPITALIT		1,578,180	1,571,843
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		6,990,910	7,057,731

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga drejtuesit e Shoqërisë në 2 maj 2017.

 Klaidi Citozi Drejtor i Përgjithshëm	 REPUBLIKA E SHQIPERISE SHOQERI SIGURIMESH SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP DREJTORIA E PERGJITHSHE	 Ilir Elmazi Drejtor Finance
--	--	--

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri në 41 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

SigmaInteralbanian Vienna Insurance Group sh.a.

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse

(Të gjitha shifrat janë në mijë Lek, përveç rasteve kur theksohet ndryshe)

	Shënime	2016	Per vitin financiar 2015
Prime të shkruara bruto	27	3,409,702	3,652,912
Ndryshimi në rezervën e primit të pafituar	23	(54,564)	(95,157)
Prime të ceduara në risigurim	28	(1,523,158)	(1,705,238)
Të ardhura neto nga primi i sigurimit		1,831,980	1,852,517
Të ardhura të tjera	29	6,437	706
Të ardhura neto		1,838,417	1,853,223
Dëme të paguara	22	(916,325)	(968,894)
Ndryshimi në rezervën e dëmeve të sigurimit dhe risigurimit	22	(13,152)	(271,940)
Dëme të sigurimit neto		(929,477)	(1,240,834)
Shpenzimet e marrjes në sigurim	30	(657,090)	(724,178)
Shpenzime administrative	31	(603,064)	(606,777)
Të ardhura nga komisionet e risigurimit		598,953	707,884
Shpenzime të tjera sigurimi		(215,907)	(112,429)
Shpenzime operative		(877,108)	(735,500)
Të ardhura nga interesi	32	109,555	79,064
Fitim/humbje nga kursi i këmbimit, neto	33	(5,044)	4,870
Shpenzime financiare	34	(26,432)	(28,599)
Të ardhura financiare neto		78,079	55,335
Fitimi/(humbja) para tatimit		109,911	(67,776)
Tatimi fitimi	35	(92,703)	(22,044)
Fitim/(humbja) e vitit		17,208	(89,820)
Rivlerësimi i aktiveve të trupëzuara		4,679	4,679
Taksa mbi të ardhurat përmbledhëse të tjera		(702)	(702)
Të ardhura përmbledhëse të tjera neto nga taksa		3,977	3,977
Totali i (humbjes)/fitimit gjithëpërfshirës për vitit		21,185	(85,843)

Sigma Inter Albanian Vienna Insurance Group sh.a.
Pasqyra e ndryshimeve në kapital


(Të gjitha shifrat janë në mijë Lek, përveç rasteve kur theksohet ndryshe)

	Kapitali aksioner	Rezerva e sigurimit	Rezerva e bashkimit	Rezerva e rivleresimit	Rezerva e kembimit	Fitimet e mbartura	Totali
Gjendja më 1 janar 2015	668,217	171,792	437,207	86,147	65,744	248,347	1,677,454
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit	-	-	-	-	-	(89,820)	(89,820)
Humbja e vitit	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse , neto nga tatimi	-	-	-	(3,977)	-	3,977	-
Rezerva e rivleresimit	-	-	-	(3,977)	-	3,977	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	(3,977)	-	3,977	-
Totali i të humbjeve gjithëpërfshirëse të vitit	-	-	-	(3,977)	-	(85,843)	(89,820)
Transaksione me pronarët të regjistruara direkt në kapital	-	-	-	-	-	-	-
Dividend i paguar	-	-	-	-	-	-	-
Totali i kontributeve nga dhe shpërndarë tek aksionarët	-	-	-	-	(15,791)	-	(15,791)
Diferenca te kursit te kembimit	-	-	-	-	-	-	-
Gjendja ne 31 dhjetor 2015	668,217	171,792	437,207	82,170	49,953	162,504	1,571,843
Gjendja më 1 janar 2016	668,217	171,792	437,207	82,170	49,953	162,504	1,571,843
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse te vitit	-	-	-	-	-	17,208	17,208
Fitimi i vitit	27,046	-	-	-	-	(27,046)	-
Transferim ne fitimet e mbartura	-	-	-	-	-	-	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse , neto nga tatimi	-	-	-	-	-	-	-
Rezerva e rivleresimit	-	-	-	(3,978)	-	3,978	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	(3,978)	-	3,978	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit	27,046	-	-	(3,978)	-	(5,860)	17,208
Transaksione me pronarët të regjistruara direkt në kapital	-	-	-	-	-	-	-
Dividend i paguar	-	-	-	-	-	-	-
Totali i kontributeve nga dhe shpërndarë tek aksionarët	-	-	-	-	-	-	-
Diferenca e kursit te kembimit	-	-	-	-	(10,868)	-	(10,868)
Gjendja ne 31 dhjetor 2016	695,263	171,792	437,207	78,192	39,085	156,641	1,578,180

SigmaInteralbanian Vienna Insurance Group sh.a.
Shënime të pasqyrave financiare

(Të gjitha shifrat janë në mijë Lek, përveç rasteve kur theksohet ndryshe)

	Për mbylljen e vitit më 31 dhjetor	
	2016	2015
Fitim /(Humbje) para tatim fitimit	109,911	(67,776)
Fluksi i parasë nga aktivitetet operative		
<i>Rregullim per:</i>		
Amortizimi	34,368	34,234
Nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme	-	2,262
Provizjion per borxhin e keq	1,104	19,137
Rënia në vlerën e drejtë në ndertesat e investuara	-	1,705
Humbja nga zhvlerësimi i aktiveve të tjera	-	16,475
Shpenzime interesi	26,432	28,599
Te ardhura nga interesi	(109,555)	(79,064)
	62,260	(44,428)
<i>Ndryshim në:</i>		
- Rezervën për primet e pafituara	32,453	163,333
- Aktivitet e risiguruesit	181,632	(165,338)
- Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	(33,928)	(11,884)
- Rezervën e dëmeve	(153,694)	354,076
- Detyrimin e taksave te shtyra	9,859	-
- Aktivin e taksave te shtyra	13,935	19,652
- Të arkëtueshmet për sigurim e të tjera	18,381	(324)
- Aktive të tjera	(23,132)	59,053
- Detyrime nga sigurim dhe të tjera	19,554	47,451
- Llogari të bllokuara	(13,475)	3,712
- Detyrime të tjera	(38,499)	(32,227)
Flukset monetare nga aktivitetet operative	75,075	393,076
Interes i arkëtuar	114,598	68,450
Interes i paguar	(26,432)	(28,599)
Tatim fitimi i paguar	(35,264)	(35,264)
Flukset monetare nga aktivitetet operative	127,977	397,663
Flukset monetare nga aktivitetet investuese		
Blerje aktivesh të trupezuara dhe të patruëzuara	(11,959)	(26,989)
Shitje e aktiveve	2,471	-
(Rritje)/Zvogëlim në depozitat me afat	(135,066)	490,124
Riblerje /(Blerje) i bonove të thesarit	20,363	(990,804)
Rritje në investime sipas metodës së kapitalit	-	(46)
Flukset monetare përdorur në aktivitetet investuese	(124,191)	(527,715)
Efektet e kursit te kembimit në mjete monetare dhe ekuivalente me to	16,880	(15,791)
Ndryshimi neto në mjete monetare dhe ekuivalente me to	20,666	(149,555)
Mjetet monetare dhe ekuivalente në fillim te vitit	176,711	338,110
Mjetet monetare dhe ekuivalente në fund të vitit (Note 11)	197,377	188,555



Aktiviteti i Auditimit te Brendshem gjate vitit 2016 ne shoqërinë Sigma Interlbanian VIG sha eshte kryer ne perputhje me Planin vjetor te Auditit te Brendshem te miratuar ne Mbledhjen e Keshillit Mbikqyres te Grupit VIG, si dhe duke u bazuar ne Manualin e Auditit te Brendshem, Karten e Auditit te Brendshem dhe ne Parimet kryesore e Auditit te Brendshem te Vienna Insurance Group.

Baza ligjore ne te cilen eshte mbeshtetur veprimtaria e auditimit te brendshem eshte:

- Ligji Nr. 52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit",
- Rregullorja e AMF "Për Veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit" miratuar me vendimin e Bordit nr. 153, datë 23.12.2014.
- Rregullorja e AMF "Per Rregullat e Organizimit te Sistemit te Administrimit te Riskut ne Shoqerite e Sigurimit" miratuar me vendim Bordi Nr. 18 Dt. 28.04.2015.


Gjate vitit 2016 Departamenti i Auditit te Brendshem ka audituar aktivitetet e marrjes ne sigurim, te shitjes, te administrimit, te risigurimeve, te menaxhimit te riskut, te trajtimit te demeve, ato juridike, te menaxhimit financiar dhe te teknologjise se informacionit, duke mbuluar keshtu plotesisht veprimtarine e shoqerise.

Aktiviteti i shitjes menaxhohet nga struktura e shitjeve te shoqerise Sigma Interlbanian VIG sha e cilat perbehet nga Departamenti i Shitjes ne Drejtorine e Pergjithshme, Deget e Shitjeve dhe nga agjentet e shitjes e ndermjetesit e tjere.

Kontrollet e Auditit te Brendshem per vitin 2016 ne aktivitetet e shitjes jane fokusuar ne zbatimin rregullores se shoqerise, rregjistrimin e sakte dhe pa vonesa te policave ne programin e shitjes, arketimin e primeve vecanerisht per produktet vullnetare, menaxhimin e llogarive te paradhenieve per shitjen, menaxhimin e komisioneve dhe bonuseve te shitjes, procedurat e marrjes se agjenteve te rinj dhe largimin e agjenteve egzistues, etj.

Jane kontrolluar dhe analizuar me se shumti risqet qe vijne si pasoje e mosrregjistrimit te policave ne sistemet informatike te shoqerise, si dhe te rregjistrimeve te pasakta sic jane ndryshimet e kategorive te automjeteve, etj.

Departamenti i Administrimit ka qene objekt auditimi gjate vitit 2016 lidhur me problematikat per rakordimet mujore te agjenteve te shitjes me deget dhe me drejtorine e pergjithshme per primet e paar- ketuara, per inventarizimin e policave gjendje, zbatimin e procedurave per policat dublikate dhe policat e anuluar, funksionimin e programit Edusoft per administrimin e policave dhe llogaritjen e komisioneve dhe bonuseve.



Aktivitetet e marrjes ne sigurim dhe menaxhimit te riskut kane funksionuar ne menyre harmonike me njera tjetren. Per cdo rast Komitet i Menaxhimit te Riskut ka analizuar risqet e mundshme dhe ka miratuar marrjen ne sigurim dhe ofertat per percaktimin e primit.


Nga kontrollet ne Departamentin e Ri-sigurimeve ka rezultuar se veprimtaria e risigurimit ka funksionuar e bazuar ne Ligjin Nr. 52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", Rregulloren e Grupit VIG per Risigurimet dhe ne marreveshjet e lidhura ndermjet shoqerise dhe risiguresve perkates. Partneri kryesor per aktivitetin e risigurimeve eshte VIG-RE i cili eshte pjese e Vienna Insurance Group. Partneret e tjere jane perzgjedhur dhe miratuar bazuar ne rankimet nderkombetare te institucioneve nderkombetare per shoqerite e risigurimeve.

Kontrollet e auditit te brendshem kane konsistuar ne perpushmerine ligjore dhe te zbatimit te rregulloreve ne fuqi, njoftimin ne kohe dhe miratimin nga ana e Departamentit te Risigurimeve te Grupit VIG lidhur me risqet e mundshme dhe percaktimin e ofertave. Gjithashtu jane audituar raportimet periodike ne Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare dhe ne Grupin VIG lidhur me objektet dhe kontratat e risigurimeve.

Veprimtaria e Departamentit Ligjor eshte e fokusuar ne perfaqesimin dhe mbrojtjen e shoqerise ne proceset gjyqesore me objekt trajtimin e demeve, pasurore dhe jo-pasurore, si dhe ato te fondit te kompensimit. Gjithashtu pjese e aktiviteve juridike te shoqerise jane primet e paarketuara te klienteve dhe subjekteve debitore, si dhe ne zbatimin e Kodit te Punes dhe kontratave perkatese lidhur me mardheniet e punes. Kontrollet e kryera nga Auditi i Brendshem ne aktivitetet juridike te shoqerise gjate vitit 2016 jane fokusuar ne analizimin dhe percaktimin e risqeve qe vijne nga zgjidhja me proces gjyqesor e mosmarreveshjeve.

Aktivitetet e trajtimit te demeve, rregjistrimit dhe administrimit financiar dhe te teknologjise se informacionit jane transferuar ne nje kompani te vecante, VIG Service Shqiperi shpk.

Auditimet e realizuara gjate vitit 2016 ne aktivitetet e trajtimit te demeve jane fokusuar ne zbatueshmerine e ligjeve ne fuqi, Rregulloreve te AMF dhe Rregulloreve te brendshme te miratuara nga shoqeria. Kontrollet e Auditit te Brendshem kane trajtuar ne menyre te vecante Demet Materiale dhe Demet Shendetsore. Ato jane kryer te perqendruara ne rregjistrimet ne programin e demeve, ne bazen e te dhenave te pergatitur bazuar ne produktet specifike dhe ne dosjet e dokumentacioneve fizike te demeve.



demshperblimit. Kontrollat e brendshme ne trajtimin e Demeve Shendetsore kane konsistuar ne rregjistrimin ne kohe dhe plotesimin me dokumentacionin e plote te dosjes se demit, vleresimin e drejte te paafetise se personit te demtuar bazuar ne Rregulloren Nr. 53 te AMF, njoftimet per perfituesit e demshperblimeve, si dhe analizimin e faktoreve te cilet cojne ne zgjidhjen me proces gjyqesore te demeve.

Administrimi financiar i shoqerise eshte audituar lidhur me saktesine e rregjistrimeve ne programin e kontabilitetit SAP, raportimet e sakta dhe brenda afateve ne insitucionet jashte shqerise (AMF, DPT, Drejtoria e Pastrimit te Parave etj.), si dhe ne raportimet e brendshme per Departamentet e tjera, Bordin Drejtues dhe Keshillin Mbikqyres.

Gjate vitit 2016 eshte analizuar gjithashtu menaxhimi i asetave ne pasuri te palujtshme dhe efektiviteti i investimeve financiare te shoqerise.

Departamenti i Teknologjise se Informacionit gjate vitit 2016 eshte audituar lidhur me mirembajtjen e sistemeve dhe programeve informatike, aplikimin e hierarkise se te drejtave te perdoruesve ne programin e shitjes dhe trajtimit te demeve, perditesimin e licencave te programeve software ne perdorim dhe mirembajtjen e sistemeve te sigurise te instaluar ne ambientet e shoqerise.

Opinion i Auditit te Brendshem

Auditimet dhe kontrollat e realizuar gjate vitit 2016 jane finalizuar me gjetjet dhe rekomandimet perkatese, te cilat jane pasqyruar ne raportet e auditimit te derguara ne Departamentet e Audituar dhe Bordin Drejtues te Shoqerise Sigma InterAlbanian VIG sha. Opinioni i pergjithshem eshte se gjate vitit 2016 nuk jane evidentuar gjetje kritike ose gabime materiale te cilat te kenë një impakt domethënës në aktivitetin e Shoqërisë.

Ne menyre te vazhdueshme Departamenti i Auditit te Brendshem ka monitoruar dhe dokumentuar realizimin e rekomandimeve te lena dhe statusin perfundimtar te tyre.

Departamenti i Auditimit të Brendshëm

Shkelqim Zhurda
Drejtor

Shoqëria është aktualisht në procesin e implementimit të kërkesave të regjimit të ri Solvency II. Solvency II ka ne thelb të tij përlogaritjen e kapitalit me bazë rreziku dhe mjaftueshmërinë e tij në mbulimin e të gjitha rreziqeve materiale me të cilat përballet shoqëria, ndryshe nga kapitali i mbajtur deri tani nga shoqëritë e sigurimit. Duke u mbështetur në udhëzimet e Vienna Insurance Group, shoqërië mëmë, ky proces ka filluar me krijimin dhe miratimin nga Bordi Drejtorëve të politikave dhe rregulloreve të brendshme, sic janë: Politika e Menaxhimit të Riskut, Plani i Vazhdimësisë të Aktivitetit, dhe Politikën e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm.

i. Risku

Në bashkëpunim me departamentet përkatese është bërë inventarizimi i rreziqeve sipas kategorive, përfshire, rrezikun e tregut, rrezikun operacional, rrezikun e likuiditetit, dhe rrezikun e reputacionit e ate strategjik, si dhe nen-kategorite e tyre.

A. Inventarizimi

Risqet kryesore/materiale te identifikuar te shoqerise jane:

- Risku i Tregut
- Risku i Marrjes në Sigurim së Jo-jetës
- Risku i Marrjes në Sigurim së Produktit të Shëndetit
- Risku i Aktiveve të Patrupëzuara
- Risku i Falimentimit të Palës Tjetër
- Risku i Likuiditetit
- Risku Operacional
- Risku Strategjik
- Risku i Reputacionit

B. Vlerësimi

Proçesi vazhdon me vlerësimin kualitativ dhe kuantitativ të risqeve.

Vlerësimi bëhet me bazë frekuence dhe shkallë rëndësie duke përdorur matricat standarte te frekuencës dhe rëndësisë (peshës).

C. Monitorimi

Monitorimi i të gjithë risqeve është i detyrueshëm të bëhet të paktën një herë në vit; më i shpejtë për risqet në nivele të lartë. Ka disa risqe per të cilat zotëruesit e tyre janë të mendimit që kontrolli/masa nuk është e nevojshme/relevante (psh. në rastin e risqeve në nivele të ulta).

D. Raportimi

Raportimi tek Bordi i shoqërise do të behet të paktën një herë në vit. Në rast se nivelet e risqeve janë shqetësuese, do të merren masa për mitigimin e tyre, fillimisht me përgjigje/reagim nga departamenti përkatës, dhe në përfundim me përgjegjësinë e Bordit për vendimet.

ii. Prova e rezistencës

Prova e rezistencës është një teknikë e cila përdoret për të matur ndjeshmërinë ndaj ngjarjeve që kanë një probabilitet të vogël për të ndodhur, por që kanë një efekt të konsiderueshëm kur ato ndodhin. Dy metodat kryesore të këtij testimi janë analiza e ndjeshmërisë dhe analiza e skenarëve.

iii. Administrimi i Kapitalit dhe Niveli i Aftësisë Paguese


Bazuar në ligjin nr. 52/2014 datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", shoqëria duhet të mbajë një fond garancie minimum në shumën 370 milion lekë (ose jo më pak se 1/3 e marzhit të aftësisë paguese minimale). Gjithashtu, marzhi i aftësisë paguese duhet të jetë më i larti ndërmjet Fondit të Garancisë dhe 150% të marzhit të aftësisë paguese minimale.

iv. Plani i Vazhdimësisë së Aktivitetit dhe Testimi i Tij

Plani i vazhdimësisë së aktivitetit është formuluar që në vitin 2011, dhe është përditësuar nga shoqëria për t'ju përshtatur ndryshimeve në strukturën e shoqërisë në dy versione të tjera.

Konkluzioni i këtij procesi ishte pozitiv, duke u bazuar në faktin që shumica e këtyre rreziqeve ishte në nivel të menaxhueshëm.


Shoqëria përdor metoda të ndryshme për transferimin apo reduktimin e rrezikut në fusha të ndryshme të aktivitetit. Një nga instrumentet kryesore që shoqëria përdor për reduktimin apo transferimin e rrezikut të marrjes në sigurim është risigurimi. Shoqëria gëzon mbështetjen e plotë të shoqërisë mëmë në këtë proces, duke e pranuar këtë rrezik nga shoqëritë brenda grupit, apo duke ndihmuar në perzgjedhjen e risigurveve me standartet më të larta.



Per here te pare, ne vitin 2016 Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group hartoi dhe raportoi në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare Testimin e Vetëvlerësimit të Riskut. Ky proces përfshinë identifikimin e të gjitha rreziqeve materiale, vlerësimin e tyre dhe raportimin te menaxhimi i lartë duke krijuar kështu në fund të procesit një profil të rrezikut të shoqërisë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2016 është bërë implementimi i Sistemit të Kontrollit të Brendshëm. Ky proces përfshin identifikimin e të gjithë rreziqeve të mundshme e vlerësimin e tyre, fushat financiare tek të cilat ka efekt rreziku, kontrollet që ka vënë në funksionim shoqëria dhe nëse ato janë të përshtatshme, dhe ngarkon me ndjekjen e rrezikut personat përgjegjës. Ky proces është shumë i rëndësishëm pasi shqyrton të gjithë rreziqet operacionale të shoqërisë, përfshirë këtu edhe rreziqet që kanë të bëjnë me përputhshmërinë ligjore, të marrjes në sigurim, të risigurimit, të rrjetit të shitjes, etj.


Objektivat e Kompanisë për vitin 2017



Besimi juaj, detyrimi ynë!

Zyrat Qendrore
Rruga Komuna e Parisit,
Pall. Lura,
Tiranë, Albania

Dega Kosove
Qyteza Pejton,
Rr.Pashko Vasa, Nr 13.
Prishtine, Kosove



www.sivig.al